



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Teori e Letërsisë

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë mësimore; 30 leksione / 10 seminare
Viti / Semestri : Viti II ,semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore:

Qëllimi kryesor i kësaj disipline është t'i shtyjë studentët të reflektojnë në mënyrë kritike mbi paradigmat teorike të përpunuara për të pyetur, për të përkufizuar, për të klasifikuar, për të menduar në tërësinë e tij fenomenin letrar, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë metodologjive dhe praktikave analizuese të nëntëqindës.

Objektivat specifike lëndorë:

1. Të propozojë një qasje të re ndaj fenomenit letrar, me bindjen se teoria nuk është një njohuri abstrakte, por një pikëpamje, një mënyrë për të parë, një instrument optik që na lejon të shohim tek tekstet diçka që ndryshe nuk do të kishim mundësi ta shikonim
2. t'u ofrojë studentëve instrumentet kryesore për analizën dhe interpretimin e një teksti letrar, shpeshherë të lënë pas dore nga tendencat aktuale të kritikës dhe të mësimdhënies që e përdorin si një pretekst për të folur për tjetër gjë (autorin, mesazhin, temat, ideologjinë, kontekstin historik-letrar etj.)

Rezultate të pritshme:

Në përfundim të kësaj lënde studenti do të ketë përvetësuar njohuri themelore mbi disa nga konceptet e përgjithshme të letërsisë, mbi funksionimin e institucioneve letrare, mbi marrëdhëniet mes tekstit dhe kontekstit si dhe njohuri mbi dinamikën e komunikimit letrar. Studenti do të njohë dhe do të dijë të përdorë metodologjitë kryesore për analizën e tekstit letrar, në përbërësit e tij retorikë, formalë, stilistikorë, tematikë dhe ideologjikë